

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 16

Premium Finance Invest*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	18,682,608	3,653
Inventari	5	49,780,694	-
Hua afatshkurtra	6	60,885,000	-
Total aktive afatshkurtra		129,348,302	3,653
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	115,500	-
Parapagime per blere asete	8	120,039,197	94,407,500
Total aktive afatgjata		120,154,697	94,407,500
Total aktive		249,502,999	94,411,153
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	9	143,500,972	6,221
Llogari të pagueshme tregtare	10	11,674,824	525,018
Detyrime tatimore	11	326,222	114,812
Të tjera detyrime	12	2,878,040	1,762,611
Total detyrime afatshkurtra		158,380,058	2,408,662
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	13	73,670,850	74,669,100
Total detyrime afatgjata		73,670,850	74,669,100
Totali i detyrimeve		232,050,908	77,077,762
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	14	20,000,000	20,000,000
Rezerva të tjera		(2,666,609)	(584,127)
Fitimi i ushtrimit		118,700	(2,082,482)
Total kapitali		17,452,091	17,333,391
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		249,502,999	94,411,153

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Premium Finance Invest*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit neto	15	(1,028,856)	(27,853)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(1,057,990)	(855,690)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
2) Të tjera shpenzime	16	(1,057,990)	(855,690)
Shpenzime të personelit	17	(864,305)	(1,219,216)
1) Paga dhe shpërblime		(750,636)	(1,120,920)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(113,669)	(98,296)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	-	-
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare neto	18	3,069,851	20,277
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(900)	(436,835)
2) Shpenzime të tjera financiare		3,070,751	457,112
Fitimi/humbja para tatimit		118,700	(2,082,482)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	-	-
Fitimi/humbja e vitit		118,700	(2,082,482)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		118,700	(2,082,482)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Premium Finance Invest

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	20,000,000	130,745	(714,872)	19,415,873
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:			(2,082,482)	(2,082,482)
Fitimi / Humbja e vitit		(714,872)	714,872	-
Pozicioni financiar i më 31 dhjetor 2018	20,000,000	(584,127)	(2,082,482)	17,333,391
Fitimi / Humbja e vitit			118,700	118,700
Lëvizjet përmes kapitalit		(2,082,482)	2,082,482	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	20,000,000	(2,666,609)	118,700	17,452,091

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.
Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

Enkelt SALLA

Enkelt Salla
Administrator



Mazars Sh.p.k

Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave

M MAZARS
Rr. Emin Durraku, Pall. "Binjoket",
No.5, 1000, Tiranë, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Premium Finance Invest
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin operativ			
Fitim / Humbja e vitit		118,700	(2,082,482)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzimet financiare jomonetare		(322,395)	(429,259)
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:			
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(60,885,000)	-
Rënie/(rritje) në inventarë		(49,780,694)	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		11,684,769	1,001,661
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		791,876	895,724
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(98,392,744)	(614,356)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(25,747,197)	(94,407,500)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(25,747,197)	(94,407,500)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Hua të arkëtuara		140,777,001	74,674,203
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		140,777,001	74,674,203
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		16,637,060	(20,347,653)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		3,653	19,922,047
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		2,041,895	429,259
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	18,682,608	3,653

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Premium Finance Invest është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar datë 14/04/2016 në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 20.000.000 Lekë (njëzet million lekë), i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 20.000.000 Lekë.

Ortakët e shoqërisë janë Power Invest, zotëruese e 1 kuote ose 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është: "kryerja e çdo veprimtarie apo aktiviteti tregtar të ligjshëm në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Në mënyrë me specifike, Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregtar import, eksporti, tregtia me shumicë e pakicë të mallrave, çdo aktivitet që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen, shitjen, transferimin, ndërtimin, nën-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, leasing e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimit e çdo të drejte apo privilegji në lidhje me këto pasuri.". Aktiviteti i shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Brigada VIII, Ndërtesa nr 6, Hyrja nr.7, Apartamenti 1, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L61711009G.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte 3 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 12 Shkurt 2016.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahaseshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.15, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82
GBP/LEK	143.00	137.42

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, për afrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale. Kuotat klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 0% .

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	18,682,608	3,653
Mjete monetare në arkë	-	-
	<u>18,682,608</u>	<u>3,653</u>

5. Inventari

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Shtesa	49,780,694	-
Pakësime	-	-
Gjëndja neto me 31 dhjetor 2019	<u>49,780,694</u>	<u>-</u>

6. Hua afatshkurtra

Huaja afatshkurtër detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua afatshkurter dhene Blue TDI	60,885,000	-
	<u>60,885,000</u>	<u>-</u>

Premium Finance Invest
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

7. Aktive afatgjata materiale

<i>Kosto</i>	Paisje kompjuterike	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Shtesa	115,500.00	115,500.00
Gjendja më 31 dhjetor 2019	115,500.00	115,500.00
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-
<i>Vlera neto kontabël</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	115,500.00	115,500.00

8. Parapagime për blerje asetesh

Parapagimet për blerjen e asetëve në 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagim për blerje asetesh	120,039,197	94,407,500
	120,039,197	94,407,500

9. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Overdraft	2,972	6,221
Financim nga WSI	113,055,500	-
Hua të tjera	30,442,500	-
	143,500,972	6,221

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë vendas	2,121,796	525,018
Furnitorë të huaj	9,553,028	-
	11,674,824	525,018

Premium Finance Invest
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	112,181	39,557
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	214,041	75,255
	<u>326,222</u>	<u>114,812</u>

12. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Pagat e punonjësve	2,028,302	1,236,426
Te tjera detyrime	849,738	526,185
	<u>2,878,040</u>	<u>1,762,611</u>

13. Hua afatgjata:

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Financim WSI	73,670,850	74,669,100
	-	-
	<u>73,670,850</u>	<u>74,669,100</u>

14. Kapitali

Kapitali I nënshkruar i shoqërisë është 20.000.000 Lek i zotëruar 100% nga Power Invest. Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur ndryshime në strukturën e kapitalit të shoqërisë. Shoqëria ka rezultuar me fitim 118,700 Lekë gjatë vitit 2019.

15. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit neto më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(1,028,856)	(27,853)
	<u>(1,028,856)</u>	<u>(27,853)</u>

Premium Finance Invest
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

16. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Materiale konsumi	5,000	4,000
Shpenzime konsulenca	757,080	720,213
Shpenzime udhetimesh	-	43,582
Shpenzime bankare	173,585	64,610
Taksa vendore	7,500	7,500
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	-	15,785
Shpenzime per dhurata	114,825	-
	1,057,990	855,690

17. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	750,636	1,120,920
Shpenzime për shpërblime	-	-
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	113,669	98,296
	864,305	1,219,216

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2019 është 3.

18. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime interesi	(900)	(436,835)
Fitim nga kembimet valutore	3,077,704	457,741
Humbje nga këmbimet valutore financiare	(6,953)	(629)
	3,069,851	20,277

Premium Finance Invest
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

19. Tatimi mbi fitimin

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	118,700	(2,082,482)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	114,825	26,678
Shpenzime per dhurata	114,825	
Shpenzime per interesa mbi normen tatimore		26,678
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	233,525	(2,055,804)
Humbje fiskale e mbartur		-
Fitimi Para Tatimit	233,525	(2,055,804)
Tatimi mbi fitimin 0%	-	-
Fitimi i vitit	118,700	(2,082,482)

20. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2019 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

21. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.